

VENDIM
Nr.417, datë 2.7.2004

**PËR KRITERET E VLERËSIMIT TË OFERTAVE PËR PRIVATIZIMIN E SHOQËRISË
ANONIME “ALBTELECOM”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7 të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë” dhe të nenit 5 të ligjit nr.8810, datë 17.5.2001 “Për përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë anonime “Albtelecom”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë dhe të Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Vlerësimi i ofertave të detyrueshme që do të paraqiten nga investitorët strategjikë, të cilëve u ofrohet paketa e aksioneve të kapitalit të shoqërisë anonime “Albtelecom” dhe përcaktimi i pikëve të vlerësimit të ofertave të kryhen sipas kriterëve të përcaktuara në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2.Ngarkohen Ministri i Ekonomisë dhe Ministri i Transportit dhe i Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano